



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1347/2 prot.

Tiranë, më 14. 12. 2021

V E N D I M

Nr. 241, datë 14. 12. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 110, datë 14.06.2021, të B. S., ku pretendohet diskriminim për shkak të *gjendjes arsimore dhe aftësisë së kufizuar*¹, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi sqaron se i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe gëzon Statusin e të Verbërit. Në vitin 2014 ka nisur studimet e larta në degën Filozofi-Sociologji pranë Universitetit “Fan Noli” Korçë. Gjatë ciklit të parë të studimeve Bachelor, ankuesi mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 227, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, të ndryshuar, ka përfutur trefishin e pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar dhe 1 (një) vit plus derisa ka përfunduar këtë cikël të studimeve.

Në vijim, ankuesi ka vijuar ciklin e dytë të studimeve Master në Universitetin e Korçës. Në 2 (dy) vitet e para, ai ka përfutur pagesën e plotë si person me aftësi të kufizuara, por nuk ka arritur të diplomohet brenda afatit 2-vjeçar, pasi nuk ka përfunduar praktikën dhe 1 (një) prej provimeve. Në këto kushte, thekson se nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Korçë është informuar se programet e studimit Bachelor dhe Master, njihen si një cikël i vetëm dhe

¹ Referuar Librezës së Verbërisë Nr. 20049, datë 07.03.2019 lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ankuesi i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, i cili gëzon Statusin e të Verbërit kategoria e I-rë.

pagesa për 1 (një) vit plus, atij i është bërë kur ka përfunduar ciklin e studimeve Bachelor. Në këtë kuptim, ai nuk mund të përfitojë pagesën sa i përket e 1 (një) viti plus sërish.

Ndërkaq nga ana e ankuesit theksohet fakti që VKM Nr. 227, datë 18.06.1997 *“Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”*, e ndryshuar, saktëson se pagesat bëhen vetëm kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vërtetohet nga titullarët e shkollave të mesme apo të larta dhe jo më shumë se një vit nga cikli normal i studimit.

Ndodhur në këto kushte, ankuesi sqaron se në pamundësi për të kryer pagesën e vitit akademik 2020-2021, nuk ka mundur të përfundojë programin e studimeve Master.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, për shkak se është përjashtuar nga e drejta për të përfituar pagesën për 1 (një) vit plus, duke bërë që ai të mos përfundojë programin e studimeve Master.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, për shkak të gjendjes arsimore dhe aftësisë së kufizuar, si dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës duke përfituar pagesën e 1 (një) viti plus, referuar përcaktimit në VKM-në Nr. 227, datë 18.06.1997 *“Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”*, të ndryshuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Neni 7 i LMD-së², të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët*

²Akronim për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Përsa më lart, referuar neneve sipërcituar të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 909/1 prot., datë 22.06.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues³ Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues⁴.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë, me anë të shkresës⁵ Nr. 1031/1 prot., datë 30.06.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...B. S. i është kryer pagesa e një viti shtesë mbi ciklin e studimeve Bachelor, në bazë të VKM nr. 277, datë 18.06.1997 ‘Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit’, e ndryshuar, e cila shprehimisht saktëson se pagesat bëhen vetëm kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vërtetohet nga titullarët e shkollave të mesme apo të larta dhe jo më shumë se një vit nga cikli normal i studimit. Nga sa u përmend më sipër, cikli normal dhe i plotë i studimit është Bachelor+Master dhe pagesë tjetër një vit shtesë nuk mund të kryhet, në bazë të VKM-së së mësipërme. Ky fakt i është bërë i ditur personit të sipërpërmendur nga institucioni ynë dhe nga Shërbimi Social Shtetëror Tiranë dhe në asnjë mënyrë nuk është diskriminuar siç personi pretendon, por thjeshtë i është cituar ligji në fuqi, në bazë të të cilit ai nuk mund të përfitojë pagesë për një vit shtesë mbi ciklin e studimeve Master, pasi kjo pagesë është kryer një herë dhe nuk mund të kryhet më shumë se një herë për një vit tjetër siç pretendohet .”

Udhëzimi Nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 ‘Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, në pikën 9 të tij parashikon

³ Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Informacion lidhur me arsyet e përjashtimit të ankuesit nga përfitimi i pagesës 1 (një) vit plus për programin e studimit Master.

⁴ Për të cilën është vënë në dijeni edhe Shërbimi Social Shtetëror

⁵ Protokolluar pranë KMD-së, me shkresën Nr. 909/2 prot., datë 05.07.2021

se: *“Për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, të verbrit nxënës, që vazhdojnë shkollat e mesme, të larta dhe arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, kanë të drejtë të marrin pagesën e verbërisë deri në përfundimin e ciklit shkollor. Pagesa që përfiton i verbri për gradën “Doktor i shkencave”, është e përhershme”.*

2. Përsa më lart, me shkresën nr. 909/3 prot., datë 08.07.2021, Komisioneri i është drejtuar Shërbimit Social Shtetëror, duke i kërkuar informacion sa i përket ankesës së B. S. Në përgjigje të saj, nga ana e Shërbimit Social Shtetëror nuk u vu në dispozicion të KMD-së asnjë informacion.
3. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 909/4 prot., datë 01.09.2021 *“Njoftim për seancë dëgjimore”*, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.09.2021, ora 12:00. Gjithashtu, ditën e realizimit të seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë, të vënë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes informacionin si më poshtë vijon:
 - A konsiderohen programi i studimeve Bachelor dhe Master, si një cikël normal dhe i plotë i studimeve?
 - A bëhet i njëjti interpretim nga Shërbimi Social Shtetëror siç bëhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë, për rastin e ankuesit ?
 - A ka patur ankesa të tjera nga persona me aftësi të kufizuara, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me B. S.? Nëse po, a është vepruar në të njëjtën mënyrë dhe sa është numri i tyre ?
 - A ka paraqitur B. S., ankesë pranë SHSSH-së, lidhur me pretendimet e ngritura ndaj Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë? Nëse po, kërkohet një kopje e korrespondencës.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të ankuesit dhe në prezencë të përfaqësueses së Shërbimit Social Shtetëror, A. Sh.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Shërbimit Social Shtetëror, depozitoi dorazi, shkresën⁶ nr. 1597/1 prot., datë 13.07.2021, ku parashtroheshin pretendimet e tyre sipas pikave të kërkuara nga KMD.

- Lidhur me pyetjen e parë: A konsiderohet programi i studimeve Bachelor dhe Master si një cikël normal dhe i plotë i studimeve?

Në përgjigjen e pyetjes i jemi referuar VKM nr.277, datë 18.6.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, pika 7, ku parashikohet se: Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e

⁶ Mbajtur në procesverbalin e seancës të nënshkruar nga palët

mesme ose kurse kualifikimi, përfitojnë dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë, kurse studentët e shkollave të larta dhe ata që janë përfshirë në studimet pasuniversitare, si dhe kanë mbrojtur gradën doktor i shkencave, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi. Këto pagesa do të bëhen vetëm kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vërtetohet nga titullarët e shkollave të mesme apo të larta dhe jo më shumë se një vit nga cikli normal i studimit.

Në Udhëzimin nr.2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, pika 8 parashikohet se: Studentët e verbër të arsimit të lartë në programe studimi të cilkit të parë dhe të dytë, ose të verbërit që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 (i ndryshuar).

Në Udhëzimin nr. 47, datë 11.01.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, pika 1 parashikohet se: kudo në Udhëzimin 2365, datë 26.11.2008, bëhen këto ndryshime. Shprehjet “kurse kualifikimi”, zëvendësohen me “kurse të formimit profesional”, “arsimi i lartë apo studime pasuniversitare”, zëvendësohen me “arsimi i lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë”, pra sa më sipër arsimi i lartë i përfshin programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor) dhe të dytë (Master i shkencave, Master i Arteve dhe Master profesional).

Duke ju referuar Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 70, pika 4, ku parashikohet se: “Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe studimi në cikle të ndryshme në varësi të llojit të institucionit, si dhe programe me karakter profesional të lartë dhe programe të formimit të vazhduar në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore”, dhe duke qenë se B. S. është rasti i parë i referuar në institucionin tonë që pretendon pagesë shtesë në ciklin e dytë të studimeve, ndërkohë që është paguar me një vit shtesë për ciklin e parë të studimeve, do ti drejtohem MSHMS për të patur një qëndrim përfundimtar lidhur me rastin.”.

- Lidhur me pyetjen: A bëhet i njëjti interpretim nga Shërbimi Social Shtetëror siç bëhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë, për rastin e ankuesit ?

Nga verifikimi i kryer në dy vitet e fundit 2020-2021, rezulton se nuk kemi patur raste ankesash të ngjashme me rastin e B. S.. Për personat me aftësi të kufizuara që janë objekt përfitimi nga ligji 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, zbatohet VKM nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës

personal”, i ndryshuar, Kreu III, pika 3 dhe 4 , ku parashikohet se: Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personat që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin, njëkohësisht, arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë dhe një kurs kualifikimi, përfitojnë vetëm njërën nga pagesat.

- Lidhur me pyetjen: A ka patur ankesa të tjera nga persona me aftësi të kufizuara, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me B. S.? Nëse po, a është vepruar në të njëjtën mënyrë dhe sa është numri i tyre ?

Nga verifikimi i kryer në protokoll rezulton se B. S. nuk ka paraqitur një ankesë pranë institucionit tonë.

Në përfundim u sqarua se Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoria Rajonale Korçë, nuk kanë diskriminuar B. S. për shkak të gjendjes arsimore dhe aftësisë së kufizuar, përkundrazi SHSSH ka si mision zbatimin e legjislacionit për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mirëadministrimin e skemës së mbrojtjes sociale.

4. Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 1347 prot., datë 23.09.2021, nga ana e KMD i është kërkuar informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me pyetjet si më poshtë:
- A konsiderohen nga ana juaj programi i studimeve Bachelor dhe Master, si një cikël normal dhe i plotë i studimeve?
 - A bëhet i njëjti interpretim i akteve nënligjore të sipërcituara, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë si për rastin e ankuesit, nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror?
 - A ka patur ankesa të tjera nga persona me aftësi të kufizuara, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me B. S.? Nëse po, a është vepruar në të njëjtën mënyrë dhe sa është numri i tyre?

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën⁷ nr. 3944/1 prot., datë 04.10.2021, vuri në dijeni të Komisionerit klasifikimin e cikleve të studimit sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1347/1 prot., datë 15.10.2021

kërkimin shkencor në institucionet arsimit të lartë në RSH”, si dhe sqaroi faktin se nuk kanë patur ankesa të tjera nga persona në kushtet e ankuesit.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Në vitin 2014 ankuesi është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, për të ndjekur ciklin e studimeve Bachelor në degën Filozofi-Sociologji. Referuar Diplomës Universitare të B. S., rezulton që ai ka përfunduar studimet Bachelor më datë 30.10.2018.

Neni 73, i ligjit Nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, parashikon se: *“1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike...”*.

Në VKM-në nr. 277, datë 18.6.1997 *“Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”*, të ndryshuar, pika 7, parashikohet se: *“Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi, përfitojnë dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë, kurse studentët e shkollave të larta dhe ata që janë përfshirë në studimet pasuniversitare, si dhe kanë mbrojtur gradën doktor i shkencave, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.*

Këto pagesa do të bëhen vetëm kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vërtetohet nga titullarët e shkollave të mesme apo të larta dhe jo më shumë se një vit nga cikli normal i studimit.

Pagesa për shkak të gradës shkencore është e përhershme dhe bëhet mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente. Fondet për këtë pagesë transferohen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale pranë institucionit përkatës ku ndodhet përfituesi, mbasi të jenë plotësuar praktikat përkatëse dhe të jenë konfirmuar nga kryesia e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë.”

Gjithashtu, në Udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, parashikohet se: “...8. Studentët e verbër të shkollave të larta, ose që përfshihen në arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ose të verbërit që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 (i ndryshuar).

9. Për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, të verbërit nxënës, që vazhdojnë shkollat e mesme, të larta dhe arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, kanë të drejtë të marrin pagesën e verbërisë deri në përfundimin e ciklit shkollor. Pagesa që përfiton i verbri për gradën “Doktor i shkencave”, është e përhershme...”.

Sipas informacionit të administruar nga palët, studimet e ciklit të parë Bachelor për ankuesit kanë zgjatur për katër vite akademike. Pra, kanë zgjatur 1 (një) vit më shumë nga kohëzgjatja normale e tyre. Për këtë arsye ankuesi, ka përfituar edhe për 1 (një) vit shtesë, trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar.

Në vijim, referuar vërtetimit datë 06.01.2021 të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, ankuesi ka vijuar ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në programin e studimit Mësues në Shkenca Sociale, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Sipas informacionit të parashtruar më sipër nga palët, në 2 (dy) vitet e para, ankuesi ka përfituar trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar.

Neni 75, pika 6, e ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.”

Në vijim ankuesi, nuk ka arritur të përfundojë ciklin e dytë të studimeve Master, brenda kohëzgjatjes normale. Për të përmbyllur studimet i është dashur që në vitin e tretë të kërkojë sërish pagesë për shkak të verbërisë, referuar përcaktimeve në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar.

Në këto kushte, ankuesi ka kërkuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, të përfitojë pagesën për shkak të verbërisë referuar përcaktimeve në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, edhe për 1 (një) vit shtesë. Në përgjigje, ankuesi është informuar nga ana e këtij institucioni se nuk mund ta përfitojë për shkak se VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, e ndryshuar, ka parashikuar në pikën 7 të saj, përfitimin e pagesës vetëm për një vit shtesë, të cilën ai e ka përfituar gjatë ndjekjes së studimeve të ciklit të parë Bachelor. I ndodhur në kushtet e pamundësisë ekonomike për të kryer pagesën e ciklit të dytë të studimeve Master dhe për të plotësuar nevojat për ndjekjen e arsimit, ankuesi është detyruar të ndërpresë studimet.

Në interpretim të situatës së sipërcituar dhe parashikimeve të akteve më sipër, Komisioneri vëren se personat/studentët e verbër, përfitojnë trefishin e e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, në rast se ndjekin arsimin e lartë, në ciklin e parë apo të dytë të studimeve. Gjithashtu, VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, e ndryshuar, ka parashikuar se këto pagesa do të bëhen vetëm kur vazhdimi i shkollave vërtetohet nga titullarët e shkollave të larta dhe jo më shumë se një vit nga cikli normal i studimit.

Në analizë të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, apo akteve nënligjore të dala në zbatim të saj, nuk rezulton që të jetë parashikuar apo sqaruar fakti se çfarë do të kuptohet me *cikël normal të studimit*.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.⁸

Për këtë, Komisioneri iu drejtua shkresërisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si organi epror që ka në misionin e saj hartimin dhe zbatimin e politikave për garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta, për t’i kërkuar interpretimin e frazës “*cikël normal të studimit*”. Në përgjigje të

⁸ <https://shendetesia.gov.al/misioni-2/>

Komisionerit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk vuri në dispozicion asnjë parashtrim lidhur me interpretimin e frazës “*cikël normal të studimit*”, por iu referua parashikimeve të ligjit Nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”.

Neni 70, i ligjit Nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, parashikon në pikën 4 se: “*Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë dhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve*”.

Neni 74, i ligjit të sipërcituar, parashikon ndër të tjera se: “*1. Pranimi në ciklin e parë të studimeve 1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave...*”.

Neni 75, parashikon ndër të tjera se: “*1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve...*”.

Ndërsa në nenin 76, parashikohet se: “*1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë...*”.

Në analizë përse më sipër, evidentohet se arsimi i lartë organizohet në tri cikle të njëpasnjëshme studimi: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë. Gjithashtu, edhe Udhëzimi nr. 2365, datë 26.11.2008, “*Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, i ndryshuar, në pikën 8 të tij, në të njëjtën frymë me parashikimet e ligjit Nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, parashikon ndarjen e arsimit të lartë në programe studimi të veçanta studimi. Në këtë kuptim, nuk rezulton që të ketë ndonjë parashikim apo akt ligjor/nënligjor, i cili të përcaktojë se cikli normal i studimit t’i referohet programeve të studimit të marra së bashku, siç ka bërë në interpretimin e saj Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë apo Shërbimi Social Shtetëror.

Pra, referuar analizës së bërë më sipër, rezulton që ankuesit i është mohuar e drejta për të përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master, për shkak të mungesës keqzbatimit të dispozitave ligjore për përfitimin e trefshit të pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, të ndryshuar.

Në këtë kuadër, bazuar në sa më sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, janë keqzbatuar dispozitat ligjore ku parashikohet detyrimi i tyre si Insitucione për dhënien e trefishit të pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, të ndryshuar edhe për 1 (një) vit në ciklin e studimeve Master për ankuesin.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror, haptazi kanë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme subjektin ankues, B. S., në raport me parashikimet ligjore për përfitimin e trefishit të pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, të ndryshuar, edhe për 1 (një) vit shtesë në programin e ciklit të dytë të studimeve.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁹, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.

⁹ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Referuar formularit të ankesës, subjekti ankues pretendon së është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe aftësisë së kufizuar.

B/1 Gjendja arsimore

Referuar dokumentacionit të arsimit të ankuesit, rezulton se me Diplomën Universitare nr. F-SB-518, datë 30.10.2018, të lëshuar nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, është diplomuar në degën Filozofi-Sociologji. Gjithashtu, referuar vërtetimit datë 06.01.2021, të lëshuar po nga ky institucion i arsimit të lartë, rezulton që subjekti ankues është student i vitit të dytë, në programin e ciklit të dytë të studimeve Master, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane.

Sa më sipër, ankuesi pretendon se gjendja arsimore është bërë shkak për diskriminimin e tij, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror.

B/2 Aftësia e kufizuar

Subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, për shkak të faktit që gëzon statusin e të verbërit, vërtetuar me anë të librezës “Për statusin e të Verbërit”, nr. 20049, datë 07.03.2019.

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara¹⁰”, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: *“Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”*.

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, si dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore kanë legjitimuar posedimin e statusit të të verbërit si aftësi të kufizuar.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse “subjekti ankues”, B. S., është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, në raport me parashikimet ligjore të posaçme, lidhur me të drejtën për të përfituar pagesën e verbërisë edhe në ciklin e dytë të studimeve Master për 1 (një) vit shtesë.

¹⁰ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj ka parshikuar se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹¹.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga

¹¹Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar¹², ka për qëllim të nxisë, mbrojtje dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: “Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

(a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;

(b) Mosdiskriminimin;

(c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;

(d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;

(e) Mundësi të barabarta;

(f) Akses;

(g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;

(h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

¹² Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

- “1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në çdo rrethanë.
3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente”.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, personat që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe aksesi në arsim. Në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare*”.

Sipas KEDNJ¹³-së, një shtet mund t’u nënshtrohet detyrimeve pozitive. Praktika relevante e GJEDNJ¹⁴-së për veprimet pozitive kryesisht i kushtohet çështjes nëse në situata të caktuara shteti është i detyruar, dhe jo vetëm i lejuar, të ndërmarrë veprime pozitive¹⁵.

¹³ Shkurtesë: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Neni 11, i LMD-së ka parashikuar dhe mundësinë e ndërmarrjes së një sërë masash pozitive, duke sanksionuar se: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”*. Pra veprimet pozitive që ka ndërmarrë Republika e Shqipërisë nuk janë një përjashtim nga parimi i mosdiskriminimit, por janë pjesë integrale e kuptimit dhe janë thelbësorë për eliminimin e diskriminimit, përparimin e dinjitetit njerëzor dhe barazisë efektive dhe të mosveçimit të kategorive të disavantazuara dhe të personave që i përkasin grupeve vulnerabël.

Në kushtet kur mungesa e arsimit për kategoritë vulnerabël, është një nga faktorët që ndikon në mosintegrimin e këtyre komuniteteve në shoqëri, institucionet publike arsimore dhe sidomos institucionet të cilët nëpërmjet politikave mbështetëse për nxitjen e arsimit duhet të tregohen më të hapur dhe të predispozuar në arsimimin e qytetarëve që i përkasin këtyre komuniteteve. Mundësia dhe politikat për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e komuniteteve të tyre dhe ndihmon në përsheptimin e integritetit të tyre shoqëror e kulturor në shoqërinë shqiptare.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat*

¹⁴ Shkurtesë: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

¹⁵ Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, faqe 77.

bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁶

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues/B. S., *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën që i buron drejtpërdrejtë nga VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, e ndryshuar.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁷, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, B. S., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, e ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

Ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, përmes

¹⁶https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁷ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

mohimit të të drejtës për të përfituar pagesën e verbërisë gjatë ndjekjes së ciklit të dytë të studimeve edhe për një vit shtesë, megjithëse aktet nënligjore të sipërcituara, subjekt i të cilit është, ia njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin e shtetit, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e ankuesit.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, akuesi ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 *“Për përfitimet nga statusi i të verbërit”*, e ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj, pagesën e verbërisë edhe gjatë ndjekjes së ciklit të parë të studimeve në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur. Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve (personat me aftësi të kufizuara), duhet të sigurohet që t’i ofrojnë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020¹⁸, citon ndër të tjera se:

“...një theks të veçantë kanë politikat dhe masat konkrete për të realizuar një arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar që ata kanë. Vizioni për vitin 2020 është që çdo fëmijë me Aftësi të Kufizuara të jetë përfshirë në arsimin bazë dhe numri i të rinjve me Aftësi të Kufizuara që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë të jetë rritur.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi të qeverisë është të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe t’u eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet dhe të drejtat e tyre. Nëpërmjet zbatimit të tij, Qeveria e Shqipërisë do të përmirësojë aksesueshmërinë e informacionit dhe shërbimeve publike, do të lehtësojë arsimin gjithëpërfshirës, do të aplikojë një vlerësim të ri të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social dhe do të zgjerojë shërbimet sociale me bazë në komunitet, shërbimet e rehabilitimit dhe masat për nxitjen e punësimit.

Gjithashtu, Plani i Veprimit parashikon aktivitete që synojnë përmirësimin ose zgjerimin e programeve ekzistuese (siç janë arsimi dhe formimi profesional, punësimi, shërbimet sociale, programet gjithëpërfshirëse të arsimit, ndihma juridike falas, etj)... ”.

¹⁸ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 483, datë 29.06.2016

Ndërsa, Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025¹⁹, citon ndër të tjera se:

“Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjecarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim.

Sigurimi i një jete të pavarur për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet: i. sigurimit të ofrimit të shërbimeve të integruara socioshëndetësore; ii. sigurimit të një jeteje dinjitoze me anë të indeksimit të pagave, punësimit, rritjes së qasjes së tyre në transportin urban dhe ndërrurban, duke përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën e tij; iii. përfshirjes së tyre në sistemin arsimor publik.”.

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale. Për arritjen e këtij qëllimi është e nevojshëm edhe mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

¹⁹ Miratuar me VKM nr. 276, datë 12.05.2021

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, subjekti ankues, mund të jetë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në raport me parashikimin e VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të saj, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, megjithëse posedonte shkakun e mbrojtur nga ligji, atë të aftësisë së kufizuar dhe këto institucione ishin në dijeni të plotë të këtij fakti.

Në këto kushte Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, kishte barrën e provës që të provonte, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e subjektit ankues përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, B. S., në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës ligjore për përfitimin e të mirave nga zbatimi i VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të saj.

Për rrjedhojë Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, ka shkelur dispozitat e ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a), dhe nenin 4, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, dhe kjo mund të realizohet nëpërmjet ofrimit nga ana e tyre, të pagesës së trefshit të verbërisë edhe për 1 (një) vit plus deri në përfundimin e vitit akademik të ciklit të dytë të studimeve Master, referuar përcaktimit në VKM-në Nr. 227, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”.

C/1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjendjen arsimore”.

Për sa i përket shkakut të pretenduar të diskriminimi “për shkak të gjendjes arsimore”, Komisioneri gjykon se nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues të ankuesit, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, me gjendjen e tij arsimore, që do të thotë që gjendja e tij, arsimore, nuk përbën në vetvete shkak, që këtij ankuesi nuk i ofrohet mundësia për përfitimin e pagesës së trefshit të verbërisë edhe për 1 (një) vit plus deri në përfundimin e vitit akademik të ciklit të dytë të studimeve Master, referuar përcaktimit në VKM-në Nr. 227, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 6, nenin 7, nenin 20 pika 1, germa a) dhe pika 4, e tij, nenin 32, germa a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, B. S., në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për shkak të aftësisë së kufizuar.

2. Në referim të pikës 1, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror, të marrin masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Arsim)